



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 27, Datë 04.02.2026

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” SH.P.K.
PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.02.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 66/4 prot., datë 02.02.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 146, datë 24.06.2021, deri më 24.06.2026
- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2983/1 prot., datë 24.12.2025, brenda afatit të përcaktuar nga Rregullorja.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 1, datë 08.01.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 09.01.2026 dhe 10.01.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 19.01.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Gjithashtu njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 66/1 prot., datë 15.01.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 66/2 prot., datë 22.01.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion shtesë, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se duhet të plotësojë dokumentacionin e mbështetjes financiare dhe të depozitojë planin e biznesit të nënshkruar/vulosur nga hartuesi, dokumentacion i cili i është kërkuar shoqërisë dhe me e-

mailin e datës 28.01.2026.

Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit

- Në nenin 14, pika 3, parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Për t'i dhënë mundësi shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. që të depozitojë dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar për këtë aplikim, në rrethanat e një aplikimi për rinovim, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë këtë dokumentacion brenda 10 (dhjetë) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 146, datë 24.06.2021.
2. Shoqëria të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI